VENDIM
Nr. 463, datë 10.7.2024

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR ORGANET E VETËQEVERISJES VENDORE, NË BASHKINË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 87, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i shtohet fondi prej 28 340 000 (njëzet e tetë milionë e treqind e dyzet mijë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme për organet e vetëqeverisjes vendore, në Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2024.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku